

Komunikojmë

Buletin tremujor mbi projektet për sistemin e drejtësisë në Shqipëri

PRILL – QERSHOR 2014

NUMRI 14

NË KËTË NUMËR:

VEPRIMTARITË NË PRILL – QERSHOR 2014	
Ceremoni hapjeje	1
Mbyllje me sukses	1
Menaxhim aktiv i çështjeve në Gjykatën e Rrethit Korçë	2
Shpjegimi i mjeteve dhe metodologjisë së CEPEJ-it	2
Trajnim për gjykatat mbi mjetet e SATURN-it	2
Fokus mbi etikën gjyqësore	2
Kodi i ri i etikës për prokurorët shqiptarë	2
Tryezë mbi arkivat gjyqësore	2
Konferencë për institucionet sociale në drejtësi	2
Trajnim mbi krimin kibernetik	3
Vizitë studimore në Itali	3
Konferenca vjetore e arbitrazhit	3
Vijon promovimi i Zgjidhjes Alternative të Konfliktëve	3
Rritje e ndërgjegjësimit për Shërbimin e Provës	3
Seminar Rajonal kundër trafikimit të qenieve njerëzore	3
Reforma kushtetuese	4
Mbështetje legjislative	4

VEPRIMTARITË E PARASHIKUARA NË KORRIK – SHTATOR 2014

NUMRAT E MËPARSHËM

Për t'i lexuar, klikoni ikonat e mëposhtme.



Të nderuar lexues,

Në përmbushje të kërkesave të ligjit për ndërmjetësimin dhe me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe USAID-it, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve (DHKN) u krijua si një ent publik juridik më 7 korrik 2013. Ajo e organizon punën e saj të pavarur nga shteti, me misionin për të mbështetur profesionin e ndërmjetësit dhe funksionimin e fuqizimin e procesit të ndërmjetësimit si një alternativë e efektshme jashtëgjyqësore për zgjidhjen e shpejtë dhe me më pak kosto të mosmarrëveshjeve me vullnetin e lirë të palëve.

Dhoma ka krijuar tashmë bazën ligjore mbi të cilën mbështetet puna e saj dhe e anëtarësisë. Përveç Statutit, kjo përfshin, ndër të tjera, Kodin e Etikës së Ndërmjetësve si dhe Manualin e Tarifave të Shërbimit dhe Ndërmjetësimit. Ndërkohë janë miratuar dhe modelet e marrëveshjeve të ndërmjetësimit dhe ndërmjetësit janë pajisur me vullën e personalizuar të prodhuar në përputhje me legjislacionin në fuqi nga Ministria e Brendshme. Që nga themelimi i DHKN-së, numri i ndërmjetësve sipas Regjistratit të Ndërmjetësve që mbahet nga Ministria e Drejtësisë, është dyfishuar. Dhoma është tashmë e përfaqësuar në Komisionin e Licencimit të Ndërmjetësve. Ajo ka organizuar me sukses në datat 4 - 6 prill 2014 trajnimin e parë fillestar për ndërmjetësimin në përputhje me detyrimin e saj ligjor për trajnimin fillestar të detyruar për ata që dëshirojnë të bëhen ndërmjetës.

DHKN-ja është përfshirë nga Ministria e Drejtësisë në hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sistemit të Drejtësisë dhe në Planin e saj të Veprimit. Ajo po zbaton dhe dy projekte me programin JuST të USAID-it për funksionimin e shërbimeve të ndërmjetësimit pranë gjykatave të rretheve gjyqësore Korçë dhe Durrës. Gjithashtu DHKN-ja, në zbatim të ligjit, ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi, si me Shërbimin e Provës, gjykata, universitete dhe me organizata jofitimprurëse.

Në njëvjetorin e saj, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve është e angazhuar, nga njëra anë, në forcimin e kapaciteteve të saj organizative dhe, në tjetrën, për rritjen e informimit të publikut për ndërmjetësimin. Ne jemi mirënjohës për mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë, ashtu si dhe ndihmën e dhënë ndër vite nga donatorët ndërkombëtarë IFC, UNICEF, GIZ dhe USAID për ndërgjegjësimin e shoqërisë sonë në lidhje me ndërmjetësimin. Ne vlerësojmë gjithashtu dhe projektin e ardhshëm nga Bashkimi Evropian në këtë fushë. Bashkëpunimi i të gjithëve është kyç për konsolidimin e profesionit të ndërmjetësit në Shqipëri dhe ofrimin e ndërmjetësimit për palët në mosmarrëveshje si një zgjedhje që nxjerr të gjithë të fituar.

Sinqerisht,

Drita Avdyli

Kryetare e DHKN-së

VEPRIMTARITË NË PRILL – QERSHOR 2014

Ceremoni hapjeje

Projekti i Përbashkët midis Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, Mbështetje për Efikasitetin e Drejtësisë – SEJ, u hap zyrtarisht më 22 maj, me pjesëmarrjen e SH.T.Z. Bujar Nishani, President i Republikës; Z. Christian Danielsson, Drejtor i Përgjithshëm për Zgjerimin, Komisioni Evropian; Z. Stephane Leyenberger, Sekretar Ekzekutiv i Komisionit Evropian për Efikasitetin në Drejtësi (CEPEJ); Z. Ildir Peçi, Zv.Ministër i Drejtësisë, si dhe të zyrarëve të nivelit të lartë dhe përfaqësuesve të gjyqësorit në Shqipëri, të shoqërisë civile, komunitetit akademik, trupit diplomatik dhe organizatave ndërkombëtare. Qëllimi i aktivitetit ishte, ndër të tjera, të prezantonte konceptet kryesore dhe aktivitetet në kuadër të kësaj nisme të përbashkët.

Mbyllje me sukses

Në muajin prill u mbyll me sukses projekti 30-mujor “Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve”, i financuar nga BE IPA 2010 dhe i zbatuar nga GIZ dhe CILC. Ndër aktivitetet përmblylëse të tij ishte trajnimi rajonal për mbrojtjen e të dhënave, i organizuar në javën e dytë të prillit, në Tiranë. Ai u përqendrua tek instrumentet dhe mekanizmat e KiE-së dhe BE-së për mbrojtjen e të dhënave në fushën e hetimit dhe ndjekjen penale të veprimtarive kriminale. Në të, vëmendje e veçantë iu kushtua rregullave dhe praktikës së mbrojtjes së të dhënave në kuadrin e Eurojust-it. Ndërkohë përfundoi punën edhe eksperti i kontraktuar nga projekti në bazë të kërkesës së Prokurorisë

së Përgjithshme (PP), për të kryer një analizë të modeleve të ndryshme të mbikëqyrjes nga prokuroria të ekzekutimit të dënimeve dhe të qendrave të vuajtjes së dënimit. Nisur nga objektivi i autoriteteve shqiptare për të luftuar korrupsionin në këto qendra, eksperti u fokusua te modelet e adoptuara nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe ato anëtare të BE-së. Në vijim, duke pasur parasysh sistemin, burimet dhe situatën aktuale, ai dha rekomandime për modelin më të përshtatshëm për Shqipërinë, si dhe për zbatimin e tij. Së fundi, me qëllim shkëmbimin e sigurt të informacionit në komunikimet ndërmjet autoriteteve qendrore dhe gjatë operacioneve delikate, projekti realizoi blerjen dhe instalimin e pajisjeve të nevojshme IT për PP-në, si dhe mundësoi trajnimin për stafin IT për të garantuar mirëfunksionimin e tyre.

Menaxhim aktiv i çështjeve në Gjykatën e Rrethit Korçë

Nisur nga rezultatet e para inkurajuese të projektit “Për një drejtësi pa vonesa” mbi menaxhimin aktiv të çështjeve, të zbatuar në gjykatën e parë pilot të Krujës me ndihmën e përbashkët të projektit JuST të USAID-it dhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, si dhe me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së, në maj 2014 filloi puna për shtrirjen e tij edhe në një gjykatë të dytë, atë të rrethit gjyqësor Korçë. Në fund të marsit, pra dy muaj nga fillimi i projektit në Gjykatën e Krujës, numri mesatar i seancave për çështjet penale kishte zbritur nga 8,8 në 1,8, ndërsa ato jokomplekse civile qenë mbyllur mesatarisht në 2,4 seanca. Gjykatat, me 4 gjyqtarë nga 6 në të njëjtën periudhë në 2013-n, kishte zgjidhur 40 çështje më shumë (një rritje prej 13%). Sipas shembullit të Krujës, në vijim të analizës së situatës së zhvillimit të proceseve

gjyqësore dhe një seminari dyditor ku diskutimet u drejtuan nga gjyqtari Truman A. Morrison nga Gjykata Superiore e Distriktit të Kolumbias, SHBA, gjyqtarët e rrethit gjyqësor Korçë miratuan një plan pune. Në 13 qershor, gjykata organizoi dy takime për t’ia prezantuar projektin aktorëve vendorë. Elementët bazë të menaxhimit aktiv të çështjeve gjyqësore përfshijnë shmangien e vonesave të panevojshme, data të palëvizshme të gjyqeve dhe pritshmëri të qarta nga gjykata për avokatët në çdo seancë, ashtu si dhe për veprimet e gjyqtarëve në rast se këto nuk përmbushen. Për zbatimin e tyre nevojitet vullnet, leadership i mirë në gjykatë, si dhe zgjidhje që rrjedhin nga arsyetimi praktik dhe jo domosdoshmërisht nga parashikimet shprehimisht në ligj. Parimet janë të njëjta si në sistemet e të drejtës zakonore ashtu edhe në ato të së drejtës civile dhe shembuj të përmirësimit thelbësor në dhënien e drejtësisë në sajë të zbatimit të tyre mund të gjenden në gjykata në mbarë botën.

Fokus mbi etikën gjyqësore

Në 7 - 11 prill, OPDAT-Shqipëri, në partneritet me Ambasadën britanike dhe atë të Izraelit në Tiranë, organizoi dhe sponsorizoi katër aktivitete të ndryshme mbi etikën gjyqësore, në përgjigje të konkluzioneve të miratuara gjatë Simpoziumit për Etikën Gjyqësore të organizuar prej saj në nëntor 2013. Aktivitetet u drejtuan nga një panel me tre të ftuar të shquar ndërkombëtarë: Loretta A. Preska, Gjyqtare në Gjykatën e Distriktit Jugor të Nju Jorkut, SHBA; Elyakim Rubinstein, Gjyqtar i Gjykatës së Lartë të Izraelit dhe Gordon Ashton, gjyqtar (në pension) nga Anglia. Në 7 prill, java filloi me një tryezë të rumbullakët me anëtarë të Gjykatës së Lartë rreth sfidave dhe dilemave të karakterit etik. Në 8 prill, tre të ftuarit ndërkombëtarë mbajtën një leksion të hapur në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit

të Tiranës, i cili u përqendrua te çështje të etikës dhe këshilla për juristët e rinj. Leksioni u ndoq nga rreth 150 studentë të programeve Bachelor e Master dhe stafi akademik. Në 9 prill, tre të ftuarit dhe gjyqtarja Valbona Vata nga Apeli Shkodër organizuan një trajnim për 28 gjyqtarë të apelit dhe inspektorë të KLD-së. Në 11 prill, gjyqtarët Preska dhe Ashton, së bashku me Kryetarin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Z. Sandër Simoni, organizuan një seancë trajnimit për 37 gjyqtarë të shkallës së parë dhe inspektorë të KLD-së. Të dy trajnimet përfshinë leksione mbi kodet e etikës dhe zbatimin e tyre, sjelljen në gjykatë dhe në jetën private, pavarësinë e gjyqësorit, paanësinë, tërheqjen apo përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi, komunikimet ex-parte (me njërin palë), etj. Trajnuesit përdorën raste hipotetike për t’i përfshirë pjesëmarrësit në diskutime aktive.

Kodi i ri i etikës për prokurorët shqiptarë

Në 20 qershor, në fjalën e tij në takimin vjetor të Asamblesë së Përgjithshme të Prokurorëve, Prokurori i Përgjithshëm njoftoi miratimin e Kodit të ri të Etikës, të hartuar me ndihmën e ODPAT-Shqipëri. Ky kod zëvendëson

një deklaratë ambicioze të 2005-s, e cila nuk ishte e aplikueshme për të gjithë prokurorët dhe nuk ishte vënë në zbatim. Kodi i ri përcakton rregulla të qarta, mekanizma zbatimi dhe mundësinë për të marrë këshilla mbi etikën. Miratimi i një kodi të ri të zbatueshëm për të gjithë prokurorët shqiptarë ishte një rekomandim i GRECO-s, Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit në KiE.

Konferencë për institucionet sociale në drejtësi

Më 24 qershor, Prezenca e OSBE-së organizoi bashkë me Universitetin e Tiranës një Konferencë Shkencore Ndërkombëtare për Forcimin e Institucioneve Sociale në Sistemin e Drejtësisë. Konferenca ishte pjesë e një projekti dyvjeçar të Prezencës

për zhvillimin e një programi ndërdisiplinor studimesh të avancuara Master, qëllimi i të cilit ishte përmirësimi i standardeve të shërbimeve sociale në përgjithësi dhe i atyre që ofrohen nga sistemi i drejtësisë, në veçanti. Konferenca trajtoi çështje që kanë të bëjnë me institucionet sociale dhe ndikimin e tyre në sistemin e drejtësisë, institucionet e drejtësisë dhe luftën ndaj krimit, sistemin e burgjeve dhe shërbimin e provës.

Shpjegimi i mjeteve dhe metodologjisë së CEPEJ-it

Më 10 qershor, në Tiranë, u zhvillua aktiviteti për rritjen e ndërgjegjësimit të grupeve të interesit në Shqipëri lidhur me instrumentet dhe metodologjinë e CEPEJ-it (KiE). Këto instrumente praktike (p.sh. Lista e Kontrollit të Menaxhimit të Kohës, ose Manuali për Zhvillimin e Sondazheve mbi Nivelin e Kënaqësisë së Publikut, etj.), u vijnë në ndihmë gjykatave për reduktimin e vonesave të pajustificuara, sigurimin e efektivitetit të proceseve gjyqësore, apo për analizimin dhe vlerësimin e punës së bërë me qëllim përmirësimit e cilësisë së shërbimit ndaj publikut. Veprimtaria gjysëm-ditore ishte një mundësi për të informuar publikun e gjerë gjyqësor mbi metodologjinë e projektit të përbashkët të BE / KiE-së, Mbështetje për Efikasitetin e Drejtësisë (SEJ), gjatë gjithë periudhës së zbatimit. Prezantimi u bë nga ekspertët e CEPEJ-it: Z. Jacques Buhler, Z. Jon Johnsen dhe Znj. Helene Jorry.

Trajnim për gjykatat mbi mjetet e SATURN-it

Në 9 - 13 qershor, në Gjykatën e Lartë, të Apelit Vlorë, të Rrethit Gjyqësor Elbasan, atë Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe të Shkallës së Parë për Krime të Rënda, u zhvillua programi i trajnimit mbi mjetet e SATURN-it, duke shënuar kështu nisjen e zbatimit të këtij komponenti të projektit SEJ të BE / KiE-së. Qëllimi i programit të trajnimit për gjykatat është shkëmbimi i njohurive mbi përdorimin e mjeteve të menaxhimit të kohës gjyqësore, veçanërisht ato të zhvilluara nga Qendra SATURN. Ai ka si objektiv t’u mundësojë gjykatave që të bëjnë një analizë të situatës në lidhje me komizat kohore gjyqësore dhe të hartojnë strategji e plane për t’i trajtuar këto çështje. Projekti synon të promovojë mjetet e SATURN-it në të gjitha gjykatat shqiptare.

Tryezë mbi arkivat gjyqësore

Më 26 qershor, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Ministria e Drejtësisë organizuan një tryezë të rumbullakët për arkivat gjyqësore me pjesëmarrjen e kancelarëve dhe punonjëseve të arkivit të të gjitha gjykatave të shkallës së parë dhe apelit. Qëllimi ishte vlerësimi i gjendjes aktuale të këtyre arkivave. Prezenca bëri një prezantim të praktikave më të mira në këtë fushë, si dhe paraqiti një tablo të kuadrit ligjor në vend, të hartuar me ndihmën e USAID-it në 2009-n. Në përfundim, Ministria e Drejtësisë dhe gjykatat u angazhuan të identifikojnë nisma të mëtejshme të nevojshme për të rritur efikasitetin e arkivave gjyqësore në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.

Trajnim mbi krimin kibernetik

Në kuadër të planit të punës të PAMECA IV, në 10 dhe 11 qershor, në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Policinë e Shtetit, u zhvillua trajnimi “Mbi përvojën shqiptare dhe italiane në hetimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik”. Në ditën e tij të parë morën pjesë prokurorë, gjyqtarë dhe oficerë të policisë gjyqësore. Ekspertë të shquar, si prokurorë italianë dhe përfaqësues nga Shërbimi i Policisë Postare dhe Komunikimit i Italisë si dhe një prokuror shqiptar, luajtën një rol të rëndësishëm si trajnues dhe folës për të sjellë

përvojën italiane dhe shqiptare në hetimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik. Ekspertët prezantuan instrumentet ligjore ndërkombëtare për krimin kibernetik, siç janë Konventa e KiE-së dhe Direktiva 2013/40 e BE-së; tendencat e këtij fenomeni; teknikat e hetimit të tipologjive të ndryshme të tij dhe provat dixhitale. Praktikant më të mira për hetimin e krimit kibernetik u ilustruan përmes rasteve studimore. Dita e dytë e trajnimit, me një natyrë më teknike e operative, iu kushtua stafit të Sektorit kundër Krimit Kibernetik në Policinë e Shtetit. Ajo shërbeu për shkëmbimin e përvojave në hetimin e këtij krimit nga një këndvështrim praktik, si dhe përfitim të njohurive të mëtejshme prej kolegëve italianë.

Konferenca vjetore e arbitrazhit

E dhe këtë vit u mbajt në Beograd, në prill, mbledhja tradicionale e specialistëve ndërkombëtarë në fushën e arbitrazhit. Çështjet e diskutuara në këtë Konferencë të 6-të të Arbitrazhit u përqendruan te dy faktorë me rëndësi për efikasitetin e procedurave të arbitrazhit: pushteti i arbitrave dhe liria e vullnetit të palëve. Paneli i parë trajtoi pyetjet mbi rolin dhe pushtetin e arbitrave të jashtëzakonshëm; pushtetin e arbitrave për të zbatuar rregullat e detyrueshme; rolin dhe pushtetin e gjykatës së arbitrazhit në rastet e sjelljes së papërshtatshme nga palët apo këshilltarët e tyre; pushtetin e saj për të ngrirë pasuritë e palëve, si dhe pushtetin e arbitrave në marrjen e provave. Në panelin e dytë, diskutimet u fokusuan në autonominë e

palëve dhe dhënien e pëlqimit për arbitrazh nën dritën e dy vendimeve të fundit të gjykatave gjermane mbi lirinë e vullnetit; kufizimet e lirisë së vullnetit të palëve në marrëveshjen e arbitrazhit; lirinë e vullnetit në zgjedhjen e ligjit material që do të aplikohet dhe kufizimet e lirisë së vullnetit gjatë procedurave të arbitrazhit. Konferenca, e financuar edhe nga Instituti Gjerman i Arbitrazhit (DIS) dhe GIZ ORF-LR, pati mbi 250 pjesëmarrës nga 30 shtete, përfshirë dhe Shqipërinë. Pas konferencës, GIZ ORF-LR organizoi në Beograd, më 5 prill, një tryezë të rumbullakët me temë Kodin e Etikës në Arbitrazh, ku morën pjesë partnerë dhe specialistë nga vendet e Ballkanit Perëndimor, përfaqësues nga ArbitralWomen dhe DIS. Tryeza ishte pjesë e aktiviteteve të GIZ ORF-LR për promovimin e Zgjidhjeve Alternative të Konflikteve në rajon.

Seminar Rajonal kundër trafikimit të qenieve njerëzore

Në 17 - 19 korrik, Këshilltari Ligjor Rezident i OPDAT-Shqipëri, Michael Vaccaro dhe Specialistja Ligjore, Alba Ibrahim, organizuan një Seminar Rajonal Ballkanik për luftën kundër trafikimit kombëtar dhe ndërkombëtar të qenieve njerëzore për rreth 40 pjesëmarrës nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Italia, ku u përfshinë prokurorë, oficerë policie, koordinatorë kombëtarë për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe përfaqësues të qeverive dhe OJF-ve. Ambasadori i SHBA-së, Alexander Arvizu, Zv.Kryeministri, Niko Peleshi, dhe Zv.Ministria e Brendshme, Elona Gjebrea, përshëndetën seminarin. Të ftuarit nga SHBA-ja: Znj. Jessica Ginsburg, dhe Z. Marcus Busch nga Departamenti i Drejtësisë, Znj. Rebecca Mermelstein, Zv.Prokurorë në Distriktin Jugor të Nju Jorkut dhe Z. Mark Lasser, Këshilltar i Lartë Ligjor në Ambasadën e SHBA-së në Maqedoni, erdhën në Tiranë për të drejtuar seminarin. Atyre iu bashkuan dy ekspertë italianë: Z. Dario Scalletta, Zv.Shef i Zyrës së Prokurorisë Italiane në Palermo

(Siçili) dhe Z. Michele Incani, prokuror për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore në Kaljari (Sardenjë). Ekspertët folën rreth konventave për trafikimin e qenieve njerëzore, dispozitat penale dhe tendencat aktuale. Ata trajtuan edhe çështje të teknikeve dhe sfidave të hetimit; identifikimin e viktimave të trafikimit; mekanizmat e mbështetjes për viktimat; rolin e tyre si dëshmitarë; strategjitë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit; përdorimin e pasurive të konfiskuara nga çështjet e trafikimit për të kompensuar dhe riatdhesuar viktimat, si dhe prezantuan raste studimore nga SHBA-ja dhe Italia. Përfaqësuesit nga katër vendet ballkanike bënë prezantime mbi situatën e trafikimit të qenieve njerëzore në vendet përkatëse dhe strukturat kombëtare të luftës kundër tij, strategjitë qeveritare për të nxitur ndërgjegjësimin dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe raste studimore. Pjesëmarrësit vunë në dukje nevojën e një platforme rajonale për një bashkëpunim më të mirë me kolegët në rajon dhe për të rritur bashkëpunimin ndërkombëtar. Ky seminar u organizua në vijim të Seminarit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore të organizuar nga OPDAT-i më 11 - 13 mars.

Vizitë studimore në Itali

OPDAT - Shqipëri dhe PAMECA IV organizuan dhe bashkëfinancuan një vizitë studimore në Palermo dhe Trapani të Italisë për gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore për krimet e rënda, në 20 - 23 maj. Ajo filloi me një takim në Departamentin e Hetimit Anti-mafie, një njësi rajonale me përfaqësues të forcave të ndryshme policore, e ngritur në bazë të ideve të Giovanni Falcone-s lidhur me nevojën për bashkërendim në luftën kundër mafies. Pjesëmarrësit në vizitë patën takime dhe me prokurorë, gjyqtarë dhe oficerë të forcave të ndryshme policore anti-mafie si në Palermo dhe në Trapani. Ato u përqendruan te historia e mafies siçiliane, legjislacioni dhe teknikat apo mjetet hetimore kundër mafies, me theks të veçantë te masat parandaluese përmes sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive. U prezantuan dhe një sërë rastesh studimore. Vizita u mbyll me pjesëmarrjen në aktivitetet e Fondacionit “Giovanni dhe Francesca Falcone”, në përkujtim të 22-vjetorit të vrasjes së Giovanni Falcone-s.

Vijon promovimi i Zgjidhjes Alternative të Konflikteve

Nënprojekti i GIZ ORF-LR-së “Zbatimi i mjeteve alternative për zgjidhjen e konflikteve i orientuar nga barazia gjinore në Ballkanin Perëndimor” mbështeti pjesëmarrjen e skuadrave nga rajoni në konkursin mbi Gjyqin Imitues të Beogradit 2014, ku morën pjesë mbi 500 vetë dhe skuadra të 56 universiteteve nga 26 shtete, duke e shndërruar atë në aktivitetin më të madh përgatitor në botë për Konkursin Ndërkombëtar për Procesin Imitues të Arbitrazhit Tregtar “Willem C. Vis”. Ky i fundit, ndër më të mëdhenjtë e më të njohurit në botë, mbahet çdo vit në Vjenë dhe ka për synim promovimin e studimit të së drejtës ndërkombëtare tregtare dhe të arbitrazhit në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare të biznesit. Skuadra me studentë të drejtësisë të Universitetit të Tiranës pati një rezultat të mirë. Falë mbështetjes nga disa studio ligjore, ajo mori pjesë për herë të parë këtë vit në Gjyqin Imitues të Vjenës.

Kritje e ndërgjegjësimit për Shërbimin e Provës

Më 28 maj, Prezenca e OSBE-së, në bashkëpunim me Shërbimin e Provës dhe Drejtorinë Arsimore Rajonale, organizoi në Durrës një tryezë të rumbullakët me rreth 30 përfaqësues të institucioneve arsimore. Qëllimi ishte miqja e ndërgjegjësimit rreth punës së Shërbimit të Provës dhe rolit të veçantë që mund të luajnë institucionet arsimore në zbatimin e dënimeve alternative. Që nga krijimi i tij në maj 2009, rreth 1.700 të mitur, autorë të veprave penale, janë mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës në Shqipëri.

Reforma kushtetuese

Nisur nga zhvillimet politike, juridike e sociale të ndodhura gjatë 16 viteve që prej miratimit të Kushtetutës, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (Soros) po inkurajon nisjen e një debati të gjerë publik mbi nevojën parësore që ka vendi për një reformë rrënjësore kushtetuese. Kjo nismë u prezantua në një aktivitet publik, në 26 maj, në praninë e drejtuesve të lartë të institucioneve shtetërore e spektrit politik, përfaqësuesve të sistemit të drejtësisë, shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar. Disa nga argumentet në mbështetje të kësaj nismë janë mangësitë e Kushtetutës së 1998-ës që kanë sjellë dobësimin e institucioneve të pavarura përballë ndikimit të shumicës politike në parlament dhe qeveri; krizat e përsëritura në raportet e parlamentit me Prokurorinë e Përgjithshme për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, apo në procesin e emërimit

të anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese, si dhe paafëzia e parlamentit për të ushtruar një mbikëqyrje efektive mbi ekzekutivin. Një tjetër argument është nevoja për të rishikuar amendamentet kushtetuese të 2008-ës, me qëllim korrigjimin e efekteve anësore të paparashikuara që sollën ndryshimet në zgjedhjen e Presidentit dhe në mekanizmin e votëbesimit të qeverisë. Ndryshimi i Kushtetutës merr dhe më shumë rëndësi në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, si hapi vijues pas marrjes së statusit të vendit kandidat, i cili automatikisht detyron përfshirjen e kuadrit ligjor të BE-së në rendin tonë juridik. Sipas Fondacionit, rishikimi i Kushtetutës është një proces kompleks e delikat dhe kërkon përfshirjen dhe kontributin aktiv të të gjithë spektrit politik (brenda dhe jashtë parlamentit), shoqërisë civile dhe grupeve të interesit. Parimet udhëheqëse të këtij procesi duhet të jenë gjithëpërfshirja dhe transparencja. Përmes adresimit të sfidave aktuale, realizimi i

tij krijon stabilitet, sepse i ruan institucionet nga ndërhyrja politike dhe forcon shtetin e së drejtës.

Mbështetje legislative

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2014, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka bërë komente për projekt-ndryshime në Kodin Penal, pas një kërkesë nga Komisioni i Ligjeve i Kuvendit. Gjithashtu, Prezenca ka dhënë mbështetje legislative mbi projektligjin për Policinë e Shtetit. Prezenca ka përgatitur dhe komente për projektligjin “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Po kështu, Prezenca ka paraqitur disa konsiderata për ndryshimin e legjislacionit aktual për Shërbimin e Provës, pas nismës të Qeverisë shqiptare për të përmirësuar kuadrin ligjor që udhëheq veprimtarinë e këtij institucioni.

VEPRIMTARI TË PARASHIKUARA NË KORRIK – SHTATOR 2014

- Aktivitete për prezantimin e Vademekumit për Avokatët, një udhëzues praktik për avokatët për procedimet civile, në disa dhoma rajonale të avokatisë dhe fakultete të drejtësisë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në bashkëpunim me DHKA-në, 7 - 24 korrik 2014
- Zhvillimi i një Sistemi për Vlerësimin e të Miturve, Autorë të Veprave Penale dhe trajnimi i punonjësve të Shërbimit të Provës rreth këtij sistemi, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 15 - 18 korrik 2014
- Konferenca e pestë Rajonale e Liderit në Gjyqësor për përdorimin e regjistrimit audio, USAID JuST, Gjirokastrë, 25 korrik 2014
- Sondazh kombëtar për matjen e perceptimit të gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, akademikëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile lidhur me nevojën për reformë kushtetuese, Fondacioni OSFA, korrik 2014
- Diskutime në fokus grupe me gjyqtarë dhe prokurorë lidhur me procesin e rishikimit të Kushtetutës, Fondacioni OSFA, korrik 2014
- Vizitë studimore në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut me pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë nga Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë, projekti SEJ i BE / KiE-së, korrik 2014
- Konferenca rajonale e SEELS-it “E drejta administrative dhe ndikimi i saj në procesin e reformës së administratës publike dhe integrimin e vendeve të Evropës juglindore në hapësirën administrative evropiane”, GIZ ORF-LR, Zagreb, Kroaci, 4 - 5 shtator 2014
- Ceremonia e nivelit të lartë për prezantimin e projektit “Për një drejtësi pa vonesa” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, e organizuar me mbështetjen e USAID JuST dhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Korçë, 10 shtator 2014
- Veprimtari për rritjen e kapaciteteve lidhur me ligjin mbi gjykatat administrative për avokatët, personelin e gjykatave dhe zyrtarët e administratës, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, shtator 2014
- Fillimi i kurseve të vitit të 3-të të programit të Arsimit Vazhdues Ligjor në 6 dhoma rajonale të avokatisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe ato rajonale në Durrës, Vlorë, Fier, Korçë, Shkodër e Tiranë, me mbështetjen e USAID JuST, shtator 2014
- Trajnim i vazhdueshëm i gjykatave, projekti SEJ i BE / KiE-së, shtator 2014
- Seminar për Prokurorinë për Krime të Rënda lidhur me krimin financiar dhe larjen e parave, OPDAT-Shqipëri, shtator 2014
- Thirrje e hapur për punime akademike me synim përfundimin e mendimeve të ekspertëve të fushës si dhe gjenerimin e ideve të reja për përmirësimin e Kushtetutës, Fondacioni OSFA në bashkëpunim me Qendrën ALTRI, korrik - shtator 2014.



USAID JuST
E-mail: office@ajssp.org.al
www.usaid.org/albania



Prezenca e OSBE-së në Shqipëri
E-mail: pm-al@osce.org
www.osce.org/albania



OPDAT-Shqipëri
E-mail: VaccaroMR@state.gov
www.justice.gov/criminal/opdat



BE / KiE Mbështetje për Efikasitetin e Drejtësisë – SEJ
E-mail: Tea.Jalishvili@coe.int
www.coe.al



GIZ ORF-LR
E-mail: christian.athenstaedt@giz.de
www.giz.de



E-mail: info@pameca.org.al
www.pameca.org.al



E-mail: info@osfa.soros.org
www.soros.org



E-mail: orflex-al@giz.de
www.giz.de

Shprehjet e falënderimit dhe mbi përgjegjësitë

Artikujt e këtij buletini janë kontribute të projekteve të donatorëve të cilët mbështesin aktivisht reformën në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Kontribuuesit mbajnë përgjegjësi të plotë për përbajtjen e artikujve të tyre, të cilat nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve apo qeverive përkatëse.